



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Efa Dienstleistung GmbH Dega Kosovë” të datës 18.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “68 Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale” me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHE**t kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Efa Dienstleistung GmbH Dega Kosovë” të datës 18.06.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “68 Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale” me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHE**t autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE**n palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Efa Dienstleistung GmbH Dega Kosovë” (tutje “parashtruesi”) me datë 18.06.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “68 Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve komunale” me nr. të prokurimit 616-25-1635-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës. Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.-

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika. 9.1& 9.2 është kërkuar që OE duhet të ketë stafi profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet si dhe pagaditje adekuate shkollë. 1.Së paku një (1)Menaxher me page bruto 600.00 €.

2.1.OE duhet të ketë stafi profesional si dhe të ketë përvojë në shërbimet si dhe pagaditje adekuate shkollë. 1.Së paku një (1)Menaxher me page bruto 600.00 €.

2.1.OE duhet të deshmohet me diplomë Universitare bachelor ose Master, minimumi 3 vite përvojë pune, referenca, CV-ja si dhe Kontrata e punës apo parakontrata. Ne analize financiare te përfshihet paga per menaxher.

Grupi i Operatorve Ekonomik (Schafberger) kanë nënshkruar kontratën e punës me menaxheri i kontratës me pagë me të lartë se ne kërkesën e AK-së ku kanë caktuar pagën 700 euro e që bje ndesh me kërkesat e AK-së dhe në analizen financiare te paraqitur nga GOE-vë ku ne analizen financiare e kanë kalkuluar me 600 euro pagë.

Provë nga pjesa e Analiza financiare te kalkuluar

Paga Bruto Menaxher	600.00 euro
Trusti Pensional	30.00 euro
Totali Pagës	630.00 euro

Kapaciteti teknik dhe profesional: pika 9.1 & 9.2

Kërkesa:

6. Operator Ekonomik duhet të të deklarohej se materialet e përdorura janë ekologjike dhe te atestuara.

6. Te dëshmohej me deklarate origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga OE kurse kërkohej edhe MSDS dhe etiketa e produktit (kopje).

Gjithashtu, dëshirojmë të theksojmë se një nga kërkesat e qarta të dosjes së tenderit, e parashtruar nga vetë Autoriteti Kontraktues, ka qenë deklarimi i materialeve të përdorura me fletë teknike (MSDS – Material Safety Data Sheet).

Operatori ekonomik që është shpallur fitues nuk është në përputhje me këtë kërkesë, duke mos dorëzuar dokumentacionin përkatës për materialet e përdorura, gjë që përbën shkelje të kriterëve teknike dhe teknologjike të përcaktuara në tender.

Kjo cenon barazinë në garë dhe bie ndesh me nenin përkatës të Ligjit për Prokurimin Publik, duke favorizuar një ofertë që nuk i plotëson kriteret bazë të pranueshmërisë teknike.

Për më tepër, kërkojmë që gjatë rishqyrtimit të merret parasysh edhe vlerësimi i mostrave të dorëzuara nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Ne kemi dorëzuar mostrat në përputhje të plotë me kërkesat e dosjes së tenderit dhe jemi të bindur se ato përmbushin standardet e kërkuara për cilësi dhe siguri.

Kërkojmë që autoriteti përkatës të vlerësojë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme mostrat e dorëzuara, në mënyrë që të sigurohet që produktet e propozuara janë realisht në përputhje me nevojat teknike të kontratës dhe jo vetëm me çmimin.

Mospërputhja me kriteret për udhëheqësin e konsorciumit:

Një tjetër çështje me rëndësi ka të bëjë me grupin e operatorëve ekonomikë që janë përzgjedhur si fitues, të cilët kanë konkurruar si konsorcium.

Sipas dokumentacioneve të dorëzuara ne oferten e GOE-ve, lideri i këtij konsorciumi nuk i plotëson kapacitetet teknike dhe financiare minimale të kërkuara nga dosja e tenderit. i mbulon vetëm partneri tjetër në konsorcium.

Kjo është në kundërshtim me Ligjit për Prokurimin Publik, sipas të cilave lideri i konsorciumit duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme për të përfaqësuar dhe implementuar projektin. Në këtë rast, vlera e përmbushjes bie kryesisht mbi një partner tjetër që nuk ka përgjegjësinë formale udhëheqëse, gjë që krijon pasiguri në zbatimin efektiv të kontratës pasi që marrëveshja e konsorciumit dhe disa nga dokumentet tjera të GOE ishte sekret afarist nuk e dim se si e kanë ndarë në % implementimin e këtij projekti

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT duke përfshirë edhe menaxherin me pagë mbi 600 euro, MSDS dhe etiketat e produktit, mostrat dhe të gjitha kërkesat tjera të DT duke përfshirë edhe ato që kontestohen nga parashtruesi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.06.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.